




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Bip. Dep.	03-02/DPK
Nr. i titullit Vendi i pranimit Nr. pages	02
Nr. Prot. Bip. Prot. Prot. No.	01-1111/16
Data Datum	15-03-2016
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.03.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-666/16 për z. Sali Asllanaj – Kryetar i Komunës së Suharekës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur pas një informacioni të deponuar në Agjencinë kundër Korrupsionit, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-666/16, për Zyrtarin e lartë, z. Sali Asllanaj – Kryetar i Komunës së Suharekës, për të cilin është pretenduar se ushtron edhe funksionin e Anëtarit të Bordit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK-së), është mbyllur për shkak se ky pretendim nuk qëndron.

Fillimisht, Agjencinë kundër Korrupsionit i ka bërë shkresën njoftuese zyrtarit të lartë z. Asllanaj, dhe ndërkohë zyrtarët e Agjencisë kanë organizuar edhe një takim me të, në të cilin nga z. Asllanaj ka deklaruar se nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik përveç Kryetar i Komunës së Suharekës.

Ndërsa në lidhje me pyetjen ose dyshimin e palës së interesuar për ushtrimin e funksionit si Anëtar i Bordit të SHSKUK-se, z. Asllanaj ka thënë se Ajo nuk qëndron.

Agjencia kundër Korrupsionit për të vërtetuar këtë, ka kërkuar nga Sekretari i SHSKUK-së informacion në lidhje me përbërjen e Anëtarëve të Bordit të SHSKUK-së dhe në informacionin e pranuar shihet se ky Bord ka Anëtarë të tjerë dhe në këtë përbërje nuk është fare z. Sali Asllanaj.

III. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Prëtem